

Dalës-Izlazna

Nr. -1-37  
Br.

Data 21.03.2018  
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 3.9 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI, mbledhja e 6) me dt.30.03.2018 (e premtë) në ora 10:00, në sallën e re të Kuvendit komunal me këtë:

## REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rekomandimet e KPF-së, të dt.28.03.2018
4. Shqyrtimi i Draft Rregullores për ndarjen e bursave dhe kompenzimin e shpenzimeve të udhëtimit
5. Shqyrtimi i Propozimit i Drejtorisë komunale të Arsimit (DAK)-ut, për pagesën e ish punëtorëve të Arsimit (sipas kontratës kolektive)
6. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit komunal
7. Formimi i grupit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit komunal
8. Shqyrtimi i Raportit financiar i Kryetarit të Komunës për vitin 2017
9. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për hartimin e Draft Rregullores për shfrytëzimin e veturave zyrtare
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri



Dalës-Izlazna

Nr. 1-15  
Br.

Data 28.02.2018  
Datum

QEBILID-ORILLIC

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.28.02.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta këshilltarë:** Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Florije Jashari, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Shaip Paloja, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bekteshi, Linda Sadiku, Arbnore Nasufi, Hysni Mjeku, Lulzim Sadiku, Samire Berisha, Aziz Bici, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ajet Berisha, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, Përparim Klinaku, drejtor i adm. së përgjithshme, Fatmir Bërbatovci, drejtor i DPUKP-së, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së, Ferid Hashani, drejtor i bujqësisë, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Arben Berisha, drejtor i DMM-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DFEZH, Slavisa Adjancic, shef i ZLKK-së, Afrim Krasniqi, përf.e KKZ-së, përf.e Federatës së futbollit të Kosovës, përf. e OSBE-së, përf. e UNMIK-ut etj.

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Rishikimi i vendimeve të Kuvendit komunal të dt.24.01.2018
  - a) Rishikimi i vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa
  - b) Rishikimi i vendimit për formimin e Komitetit për komunitete
  - c) Rishikimi i vendimit për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
4. Shqyrtimi i kërkesës për iniciimin e procedurës për ndryshim plotësimin e Rregullores komunale për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha
5. Ndarja e parcelës për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Milloshevi
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë për periudhën shkurt 2018 deri në dhjetor 2019
7. Bartja e mjeteve buxhetore nga viti 2017 në vitin 2018
8. Formimi i Komisionit për dhënjën e pronës komunale në shfrytëzim
9. Shqyrtimi i kërkesës të Federatës së Futbollit të Kosovës
10. Shqyrtimi i kërkesave
11. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – Fillimisht ju njoftoj se kemi një ndryshim nga anëtarët e Kuvendit komunal dhe para se të hyjmë në rend dite, ftoj z.Slavisa Spasic, të japë betimin për këshilltarë të Kuvendit i cili vjen nga komuniteti sërb.

**Slavisa Spasic** – Jepë betimin solemn për këshilltarë të Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës dhe propozoi që pika e 9 të kaloj në pikën e 3të, të rendit të ditës.

**Shaip Paloja** – Sa i përket rendit të ditës, pajtohem që pika e 9 të kaloj në pikën e tretë, por propozoj që pika e pestë të hiqet nga rendi i ditës, për arsye se ne nuk kemi informata të bollshme për këtë rend dite.

**Burim Gërguri** – Sqaron se Drejtoria e shëndetësisë dhe urbanizmit e ka përgatitë pikën e pestë të rendit të ditës dhe atë nuk mund ta heqim sepse është fjala për një donacion të cilin nuk dojmë ta humbim.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 12 vota "Për" e aprovuan propozimin e parë që pika e 9 të kaloj në pikën e 3 të rendit të ditës.

**I.Pika e parë e rendit të ditës** – Të gjithë këshilltarët komunal janë të pranishëm.

**II.Pika e dytë e rendit të ditës** –

**Shaip Paloja** – Paraqet vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar sepse ne si grup i LDK-së, e kemi lëshue seancën para dhënjes së emrave për përfaqësim të anëtarëve në KPF, ndërsa kjo në procesverbal nuk është cekë. Mirëpo, aty thuhet se para votimit grupi i LDK-së, e ka lëshue seancën, kështu që kërkoj të ceket në procesverbal se ne e kemi lëshue seancën para dhënjes së emrave në KPF. Te votimi i Nënkryetarit për komunitete, mendoj se aty duhet të definohet votimi që edhe është obligative me emër e mbiemër se kush ka votue "Për" e kush "Kundër", e jo të shkohet në paketë.

**Burim Gërguri** – Sekretaria e Kuvendit, gjithsesi do ti evidenton vërejtjet e cekura më lartë dhe do ta bën përmirësimin. Mirëpo, ne atë ditë e kemi zgjedhë formën e votimit të thjeshtë dhe ju jeni ata që vendosni për çdo vendim, kështu sot nëse jeni dakord mund të shkojmë një anëtar një votë dhe shenohet gjithë.

**Dragan Dancetovic** - Sa i përket ekstraktit të procesverbalit, në faqen nr.4, në rreshtin 4 thotë se unë Dragan Danqetoviqi "kam propozuar z.Slavisha Jakovljeviq nga SLS-ja, për anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa. Unë në këtë mbledhje rreth kësaj çështjeje nuk jam paraqitur për diskutim, nuk kam diskutuar dhe kërkoj që konstatimi i tillë të fshihet nga procesverbalit. Me gjasë se është ndo një gabim dhe kërkoj që ky gabim të përmirësohet. Nuk besoj se është ndonjë qëllim i keq.

Aprovohet unanimisht ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjet e cekura më lartë.

**III.Pika e tretë e rendit të ditës** –

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës dhe ia jepë fjalën z.Fadil Vokrri.

**Fadil Vokrri**, Kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës – Mendoj se me një punë të përbashkët ne do ta bëjmë një kompleks të mirë dhe pavarësisht investimeve, që ne do ti bëjmë Komuna është pronare e tokës, që besoj se do të keni qasje kur të vjen koha e punësimit që gjithmonë përparësi të kenë njerëzit nga Obiliqi. Shpresoj se kjo do të hasë në mirëkuptim dhe njëherit ju falenderoj në emrin tim dhe të Komitetit ekzekutiv, duke ju dëshiruar suksese në punë.

**Shaip Paloja** – Mendoj se kjo kërkesë duhet të pranohet dhe të jepet në shfrytëzim ky kompleks që ne e disponojmë, por ne duhet të jemi të vendosur që në këtë kompleks të jemi partner të barabartë, të kemi përparësi në punësimin e të rinjëve tonë, që do të jenë një numër i konsiderueshëm edhe gjatë ndërtimit të kompleksit. Gjithashtu duhet të jenë të përfshirë në stafin që do ta mbikqyrë dhe mirëmban në të ardhmen këtë kompleks modern. Ne duhet të kemi kujdes në marrëveshjen që pason në mes të Federatës dhe Kuvendit komunal, që të jenë të përfshira të gjitha kërkesat që dalin nga klubet që do të funksionojnë në Obiliq dhe punësimi duhet të jetë primar që të punojnë të rinjtë e Komunës tonë.

**Aziz Bici** – Ne në parim këtë kërkesë e përkrahim ndërsa, për atë që është ofruar brenda kësaj kërkesë, propozoj të presim marrëveshjen se çfarë ofron sepse në pikën e parë të obligimit të tyre nuk janë të caktuara afatet e investimet për këto 3 milion euro. Përveç pikës se do të investohet, nuk dihet se për çfarë ndërtese të qendrës bëhet fjalë dmth janë disa çështje që ne nuk i kuptojmë. Në pikën e dytë obligohen të punësohen punëtorët nga Komuna e Obiliqit, për aq sa kanë mundësi, kështu deklarohen, por nuk dihet as minimumi i numrit të punëtorëve. Mendoj se së paku një minimum i punëtorëve, këtu është dashur të përfshihet. Pika e tretë është te dyshimi kur deklarohen se në tërësi do ta menaxhojnë kompleksin, a është fjala edhe për sallën e sportit që e kemi tash në shfrytëzim. Në pikën e 4, deklarohen se manifestimet kulturore dhe sportive që i organizon Kuvendi komunal do të jenë papagesë, që kjo është në rregullë. Ndërsa pika e fundit për mua këtu është diçka e paqartë sepse thuhet klubi amë të zhvilloj aktivitetet e veta, por fjala është për shpenzimet e bëra, që sipas meje klubi amë duhet të paguaj për aktivitetet e veta. Mendoj se duhet të jepen edhe sqarime shtesë rreth këtyre pikave.

**Hysni Mjeku** – Në parim edhe ne do ta përkrahim këtë kërkesë, por në seancën e ardhshme të Kuvendit komunal duhet të na sjellet marrëveshja e nënshkruar në mes të Kuvendit komunal dhe Federatës së futbollit të Kosovës, përndryshe ne nuk i dijmë detalet e marrëveshjes, nuk i dijmë obligimet e Federatës dhe klubi amë siç ceket këtu nuk mund të jetë qiraxhi në vendin e vet. Të gjitha detalet duhet të precizohen dhe konkretizohen në marrëveshjen e nënshkruar dhe njëkohësisht duhet të ceket saktë përafërsisht edhe numri i punëtorëve të punësuar në këtë kompleks sportiv. Kjo nga fakti se ne kemi përvoja të hidhura në objektet që janë ndërtuar me vendim të Kuvendit komunal dhe nuk janë marrë parasysh asnjë punëtorë i punësuar. Unë po e ceku vetëm Deponinë e regjionit në Mirash, që absolutisht nuk është marrë parasysh asnjë kërkesë e Kuvendit komunal dhe ai menaxhon qysh don vet. Prandaj, për hir të kontributit të jashtëzakonshëm të z.Fadil, unë jam për me i ndihmue, por në një marrëveshje të bazuar në kushtet tona, në ligj dhe në obligimet që do të rrjedhin. Psh ne këtu, nuk e dijmë se në cilat perioda do të investon, është për 25 vjet që ne ndoshta për këto vite nuk jemi gjallë dhe s'dojmë me ua lënë atyre, që do të vijnë pas neve një marrëveshje që e dëmton Komunën tonë, gjegjësisht e dëmton qendrën sportive. Unë besoj se bashkëpunimi do të jetë i mirëfilltë, por i nderuari Kryetar z.Xhafer Gashi dhe Kryetar i Federatës së futbollit z.Fadil, kërkoj që mundësisht në seancën e ardhshme të na sjellet marrëveshja në mënyrë të detalizuar sepse këto janë detyrime afatgjate.

**Nazmi Gashi** – E falenderoj Kryetarin e Federatës së futbollit dhe sekretarin që na kanë përzgjedhë neve sepse këto investime kanë mund me shkue në Komunit tjera. Prandaj edhe ne duhet ti besojmë shumë dhe të votojmë për arsye se në sport nuk fiton askush përveç djersë e mund, përndryshe aty nuk ka ndonjëfarë fitimi.

**Fadil Vokrri**, Kryetar i Federatës së futbollit të Kosovës – Sigurisht se Kryetari do ti merrë parasysh shqetësimet e juaja dhe unë i kuptoj shqetësimet e juaja. Ne punimet i fillojmë menjëherë sepse nuk presim 25 vjet. Në takimin e parë që kemi pasë me Kryetarin i kemi tregue se ne po i presim procedurat derisa të kryhen dhe në atë moment që e marrim dritën e gjelbërt nga ju, ne mund të punojmë menjëherë sepse i kemi fondet e ndara. Stadiumi bëhet i ri, aty ku është aktual dhe 2 fushat ndihmëse ku janë, një bëhet me bari artificial (projektin tonë që kemi mendue) dhe një me bari natyral dmth janë 3 fusha. Poashtu, do të bëhet një tribunë deri në 3,000 ulëse, që mendoj se është krenari edhe për juve që përfaqësuesja e Kosovës, të bëjë këtu stërvitje dhe të jetë pjesë e Obiliqit.

**Burim Gërguri** – Ju falenderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe sqarimin, por falenderim i veçantë shkon për Kryetarin e Komunës, i cili në mandatin e kaluar ka arritë që atë kompleks sportiv ta kthej nga prona shoqërore në pronë komunale. Palestra sportive, z.Aziz nuk është pjesë e këtij kompleksi dmth është pronë komunale. Mendoj se ky është një hap jashtëzakonisht i madh për qytetin dhe të rinjtë e Obiliqit, dhe ne sot po japim pëlqim për negociimin e marrëveshjes në mes të Kryetarit të Komunës dhe Federatës së futbollit të Kosovës. Ndërsa, Kryetari i Komunës, obligohet që gjithsesi marrëveshjen e nënshkruar në mes të Kuvendit komunal dhe Federatës së futbollit ta sjellë në Kuvendin komunal.

**Aziz Bici** – Të gjithë jemi falenderues, që ky investim këtu do të bëhet dhe ne s'jemi kundër këtij investimi. Ne deri më tash nuk kemi ndonjë informacion se është bërë ndonjë menaxhim si duhet prej Kryesisë së klubit, ose prej kujt është udhëheqë stadioni jonë. Këtu, fjala është rreth pikave që biseduam më heret rreth punësimit, rreth kohës se kur do të bëhen investimet dhe kush është subjekti që e garanton marrëveshjen ashtu qysh ne e kërkuam në parim.

**Burim Gërguri** – Përgjegjet se subjekti që garanton është Gjykata, por duke e njoftë Kryetarin e Komunës dhe vullnetin e tij në të kaluarën dhe tash, besoj se ka me nxjerrë maksimumin prej kësaj marrëveshjeje, e cila do të vjen para juve në Kuvend.

**Aziz Bici** – Në rast se marrëveshja që do të arrihet në mes të Kryetarit të Komunës dhe Kryetarit të Federatës vjen me marrë miratimin para se të procedohet ne do ta votojmë.

**Ajet Berisha** – E falenderoj shumë Bordin ekzekutiv të Federatës së futbollit që fillimisht këta janë përcaktue që një investim i tillë me ndodhë në Komunën tonë. Aspekti i klubit z.Aziz, s'ka të bëjë fare me investimin që do të ndodhë, por ka lidhje me krijimin e kushteve për këtë klub që Obiliqi, do të jetë

një pikë referimi për gjeneratat e reja. Bashkëpunimi ka qenë mbi 1 vit në mes të Kryetarit dhe Federatës, me Ministrinë dhe me AKP-në, sepse ka qenë pronë e tyre. Nëse ju pajtoheni për dhënjen në shfrytëzim të kompleksit sportiv të gjitha shqetësimet e juaja do të bëhen pjesë të marrëveshjes finale si numri i punëtorëve, mënyra e shfrytëzimit, klubi amë, Komuna dhe Federata. Nëse, keni këshilla se çka është dashur me qenë pjesë e memorandumit emailat, i keni dhe mund ti dërgoni. Ndërsa, votimi i sotëm është nisja e procedurave, që ligji i përcakton. Ne shpresojmë të mos hyjmë në shpallje publike sepse kjo do të na i lehtësonte shumë procedurat përndryshe duhet me ndjekë rrugën që e thotë ligji dhe ju u deklaruat se jeni të pajtimit për këtë investim, por me sqarim dhe ky sqarim do të jetë në memorandumun e bashkëpunimit.

**Aziz Bici** – Ne nuk jemi kundër dhënies në shfrytëzim të kompleksit sportiv dhe ne jemi për me dhënë, e jo me na nejtë kot ai kompleks sportiv. Ne e falenderojmë Federatën që e kanë bërë përzgjedhjen Komunën tonë dhe shqetësimet tona nuk janë për me i nënvlerësue sepse ne kemi një përvojë të hidhur për këto vite të tëra, që janë deklarue para të majme dhe nuk janë investue asnjëherë. Prandaj, shqetësimet duhet me i marrë seriozisht dhe absolutisht nuk është dashur me humbë kohë për dhënjen në shfrytëzim sepse askush nuk tha se s’duhet të jepet në shfrytëzim kompleksi sportiv. Mirëpo, ajo marrëveshje para se të arrihet ka qenë mirë të sjellet, ta shohim edhe ne që të dijme se çka po votojmë. Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me 19 vota “Për” asnjë votë “Kundër” dhe 2 vota “Abstenim” morën këtë :

#### V E N D I M

**Për dhënjen e Pëlqimit për negocimin e marrëveshjes në mes të Kryetarit të Komunes dhe Federatës së Futbollit të Kosovës për dhënien në shfrytëzim të kompleksit sportiv në Obiliq të parcelës nr.P-72614055-01459-13, në sipërfaqe prej 88299 m<sup>2</sup> dhe parcelë s nr.P-72614055-01459-1 në sipërfaqe prej 14518 m<sup>2</sup>, ZK- Obiliq në periudhën 25 vjeçare.**

**Kryetari** – Jam shumë mirënjohës dhe falenderues që Federata jonë ka përzgjedhë Obiliqin, që investimi i parë i cili do ti ndodhë vendit të Kosovës, të jetë pikërisht në Obiliq. Unë besoj se gjithçka që po ndodhë është në të mirë të qytetarëve, të Komunës tonë në radhë të parë, pastaj të qytetarëve të Kosovës. Mendoj se edhe çështja e punësimit dhe marrëveshjeve duke konsideruar z.Eroll si familje dhe z.Vokri si pjesë të familjes nuk do të ketë ndonjë tendencë sepse edhe këta përfaqësojnë një institucion qysh e përfaqësojmë edhe ne. Mendoj se UEFA, mjetet e para do ti derdhë në Komunën tonë dhe ne do të mundohemi të jemi pjesë aq sa kemi mundësi në shfrytëzimin e aktiviteteve, në ndihmën rreth infrastrukturës ligjore. Unë zotohem para juve, se do të bëjë maksimumin që marrëveshja të jetë sa më e mirë, e favorshme për të dy palët dhe patjetër që do ta sjellim para Komisionit të Kuvendit komunal për dhënjen e pronave në shfrytëzim. Ju këshilltarë të nderuar, të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që i keni e që janë të arsyeshme, ne mund ti inkorporojmë në marrëveshjen që do të përgatitet me Federatën.

#### **IV.Pika e katërt e rendit të ditës -**

**a)Burim Gërguri** – Lexon kërkesën për rishikim të 3 vendimeve, të dt.24.01.2018, nga MAPL-ja, për arsye të mospërfaqësimit gjinor sipas Ligjit për barazi gjinore.

Tani kemi rishikimin e vendimit për formimin e KPF-së, që ne nuk kemi shkruar emër, por në vendim vetëm e kemi shkruar LDK, gjinia femërore për me arritë kuotën e 30 %-it.

**Shaip Paloja** – Ne edhe në seancën e kaluar kemi qfaqë pakënaqësi me përfaqësimin tonë në KPF dhe arsyeja që e kemi lëshuar seancën ka qenë ajo, që ju e dini të gjithë dhe është shumë mirë që MAPL-ja, e ka kthyer në rishqyrtim këtë vendim për KPF-në dhe për Komitetet tjera. Mendoj se këtu është me rëndësi të sqarohet pozita e kryesuesit dhe kjo është thelbësore e bazike. Kryesues, të lutem na prezentoj ndonjë dokument ose diçka me shkrim ku thuhet se kryesuesi shkon ex-oficio në KPF. Kjo nuk qëndron sepse ju si kryesues jeni përfaqësues i një subjekti politik dhe e di se duhet ta kryesoni KPF-në, por ju njëkohësisht edhe e përfaqësoni subjektin tuaj politik. Unë e kam thënë dhe po e them prapë se ju në vota të barabarta e keni të drejtën e votës së dyfishtë në KPF, prandaj nuk ka nevojë që Aleanca të ketë më shumë anëtarë në krahasim me LDK-në. Unë kërkoj që LDK-së, ti jepet mundësia që ta zbatoj ligjin

50 me 50 patjetër, por përfaqësimi ynë në Komitete të jetë ashtu siç jemi fuqi politike në Kuvend. Kjo do të thotë se zgjedhja është se ne duhet ti kemi 2 anëtarë, 1 të gjinisë mashkullore dhe 1 të gjinisë femërore, që edhe do ti japim sot emrat. Paraprakisht duhet të sqarohet edhe pozita e kryesuesit sepse nuk qëndron ajo që ju po thoni.

**Burim Gërguri** – Unë nuk kam dokument, por kjo është e shkruar dhe e di se ju keni bërë një ankesë në MAPL, që është çështje e afatit për kthimin e përgjegjes. Atë ditë është ngritë çështja se si llogaritet kryesuesi i KPF-së, që shkon ex-oficio se Kuvendi e ka zgjedhë, i ka disa përgjegjësi që ligji ia ka dhënë.

**Lulzim Sadiku** – Vërtetë, kryesues ju jeni ra në kundërshtim me KPF-në, sepse i keni më shumë se 50 %, që udhëheqet nga AAK-ja, duke marrë parasysh se i ke 3 kandidatë, votën e dyfishtë, ju e keni mbi 50 % KPF-në. Është mirë të gjendet një konsensus që 2 kandidatë ti ketë AAK-ja, 2 LDK-ja, 1 kandidatë ta ketë PDK-ja, 1 LVV dhe 1 LB. Mendoj se këtë që e thashë unë është e vetmja zgjidhje që mund ta përfaqësoj KPF-në.

**Burim Gërguri** – Të falenderoj për kontributin, por ne më shumë ishim duke folë për çështjen thelbësore për gjininë femërore, e jo për emra dhe përbërje të KPF-së. Unë kërkoj propozime konkrete sepse në KPF, në minimum duhet të jenë 3 femra.

**Aziz Bici** – Ju njoftoj se ne e kemi bërë një kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit tuaj në MAPL, lidhur me mospërfaqësimin e LVV në Komitete. Tani, si rrjedhojë e mospërfaqësimit partiak e gjinor në këto Komitete, me këtë rast anashkalimi i LVV bie në kundërshtim me Udhëzimin administrativ të MAPL-së, neni 6, pika 1 po citoj: “Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet nga përfaqësuesit e subjekteve politike, që përfaqësohen në Kuvendin e Komunës, përbërja e tij duhet të reflektoj përfaqësimin e etniteteve politike si dhe numrin e ulësve nga etnitetet politike në Kuvend”. Ndërsa neni 57, pika 1, e Statutit të Komunës së Obiliqit thotë: “Të gjithë anëtarët e KPF-së, duhet të zgjedhen nga radhët e Kuvendit komunal, anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyroj proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimit gjinor në Kuvendin e Komunës”. Duke marrë për bazë këto nene dhe nenet tjera, ju ftoj që të reflektoni dhe të bëni një gjithëpërfshirje duke përfshirë edhe përfaqësimin nga LVV-ja, me një anëtar në këtë Komitet. Mendoj se nuk është mirë të sjelleni me kaq arrogancë, që edhe pse i keni numrat ne prapë do të ankohe mi dhe nuk do të lejojmë që të anashkalohe mi. Prandaj, propozojmë që në KPF të gjitha partitë të kenë përfaqësim dhe ne nuk kemi asgjë kundër LB-së, por ata kanë 2 asambleistë dhe ne i kemi 2 asambleistë, kështu që edhe neve na takon të jemi njëjtë të përfaqësuar. Edhe ne kishim mund të merremi vesh me ndonjërin nga partitë me LDK-në, apo PDK-në, që përkohësisht të marrim një anëtar ashtu si vepruat ju me LB-në dhe Nismën, por kjo është një lojë që ju nuk është dashur kështu të gjendeni.

**Burim Gërguri** – Rishikimi i vendimit ka ardhë konkretisht për gjininë femërore dhe unë dua propozim konkret nga partitë politike, një përfaqësim sipas Ligjit për barazi gjinore 50 %. Z.Aziz, të lutem bazuar në Rregulloren e punës, janë të tjerët me rend pastaj e marrë fjalën.

**Aziz Bici** – Ju thatë se këtu është ligji dhe ligji do të jetë kur të kthehet përgjegjja nga MAPL-ja, dhe aq sa ke ti të drejtë kam edhe unë të drejtë të thirrem në të, as ti nuk je kompetentë me u thirrë në Statut dhe në Udhëzime administrative, sepse këto i kemi të barabarta. Unë ju ftoj të mos përsëriten çështjet sepse jam shumë i sigurtë që MAPL-ja, do të marrë vendim të drejtë në interesin tonë sepse ligji thotë ashtu.

**Burim Gërguri** – Konsideroj se askujt e drejta nuk i është cënuar sepse është edhe Udhëzimi administrativ për formimin e Komiteteve obligative dhe besoj se kemi qenë shumë transparentë në mbledhjen e dt.24.01.2018 për çdo vendim që e kemi marrë.

**Hysni Mjeku** – Pyet se a është e informuar MAPL-ja, për këtë seancë që ne sot po e mbajmë dhe pse nuk i monitorojnë punimet e Kuvendit. Ne jemi në proces të konstituimit të organeve dhe është më se e nevojshme të jetë prezentë MAPL-ja, sepse e kanë zyren ligjore. Besoj se në këtë rast formulën duhet ta zgjedhë AAK-ja, sepse topi është te ju dhe ju lutemi nuk ka nevojë psh dikush të jetë inferior ndaj të tjerëve sepse ligji e thotë se edhe Komiteti dhe Kuvendi punojnë për interesa të qytetarëve. Konsideroj se nuk duhet të humbim kohë dhe parimisht është se kësaj radhe AAK-ja, duhet të jetë pak më zemërgjerë,

që ti shikoj edhe subjektet tjera politike sepse nëse ndahen taborret kush është “Për”, e kush “Kundër” atëherë punimet e këtij Kuvendi nuk do të kenë suksese. Unë besoj se vendimet e këtij Kuvendi janë të fuqishme me shumicë votash ashtu qysh e votuam kërkesën e Federatës, dhe ashtu duhet të jenë edhe këto tjerat. Unë e di se MAPL-ja, e përcjellë Kuvendin në mënyrë elektronike por në këtë fazë që po kalon Kuvendi ynë dhe shumë Kuvende tjera komunale, së paku është dashur që një përfaqësues të jetë këtu fizikisht sepse kemi të bëjmë me pyetje e përgjegje dhe jo që ne nuk i dijme çështjet, por jemi ardhë në situatën se çfarë të bëjmë.

**Burim Gërguri** – Sqaron se ata njoftohen 7 ditë përpara dhe inçizimin janë duke e marrë drejtëpërdrejtë, monitorojnë me teleprezencë dhe fizikisht më nuk vijnë. Shumica e Komunave, e kanë problemin e përfaqësimit gjinor dhe tash kërkoj propozime konkrete prej AAK-së.

**Enver Gashi** – Ne si Aleancë, edhe pse jemi grupi më i madh parlamentar normal se do ta kemi edhe përfaqësimin më të madh edhe në Komitete e Komisione, sepse jemi më shumë. Mirëpo, edhe me partnerët që jemi në koalicion dhe me tjerët këtu, e kemi për obligim që këtë problematikë ta tejkalojmë dhe duhet ta tejkalojmë sepse nuk është problem i madh që në KPF duhet me caktue një anëtar të gjinisë femërore. Propozoj që në vendin tim znj.Florije Jashari të shkoj në KPF.

**Fatos Kurshumlja** – Unë e kam një mendim më ndryshe sepse përderisa vendimin e ka kthye MAPL-ja, ju z.Burim nuk e keni as emrin e LDK-së, e ke vetëm të shenuar gjinia femërore. Ne atë ditë nuk kemi qenë prezentë në seancë dhe tash ju e keni edhe një problem tjetër se grupi parlamentar i LDK-së, nëse merrë vendim e dërgon një anëtar mashkull, e jo femër.

**Burim Gërguri** – Unë nuk e kam ndërmend me ua imponue, por e kemi të drejtën me marrë propozim prej juve. Unë e falenderoj z.Enver, për kontributin dhe gatishmërinë e tij, por prej zonjave që janë në grup nëse dojmë të bëhemi gjentëlmen duhet ti propozojmë.

**Fatos Kurshumlja** – Gjentëlmena kemi, në fakt por ju z.kryesues nuk po tregoheni gjentëlmen sepse po të tregoheshit gjentëlmen ne duhet të jemi me 2 përfaqësues, me një anëtar të gjinisë femërore dhe një të gjinisë mashkullore, por në këtë moment ti nuk po tregohesh gjentëlmen.

**Shaip Paloja** – Kryesues këtu, nuk është çështje gjenlëmeni apo e këshillave, këtu obligon ligji dhe Udhëzimi administrativ. Ligji thotë se përfaqësimi i partive politike në Kuvend duhet të jetë reciprok edhe nëpër Komitete, jo që po e shpiku unë, por kjo është kështu. Prandaj, ti duhet të bëhesh gjentëlmen dhe ta zbatosh ligjin dhe neve, të na japësh numrin që na takon në Komitet. Nëse, ju pajtohemi dhe të gjithë asambleistët tjerë, që ne ti marrim anëtarët aq sa na takon, atëherë ne do ta respektojmë ligjin dhe do ti japim 50 me 50, një emër të gjinisë mashkullore dhe një emër të gjinisë femërore. Komiteti i seancës së kaluar më nuk ekziston sepse kryesues e din që edhe para seancës nuk është thirrë për me caktue rendin e ditës sepse e ka kthye MAPL-ja. Nëse, edhe caktohen emrat tjerë, nuk ka të keqe kurgjë sepse është inekzistentë nga se MAPL-ja e ka kthye, edhe pse është bazë kuota e gjinisë femërore.

**Burim Gërguri** - Për këtë arsye unë kërkoja propozime konkrete, që s’pati përveç z.Enver me ç ‘rast 2 përfaqësime nga grupi i AAK-së, të gjinisë femërore shkojnë në KPF.

**Lulzim Sadiku** – Me u thirrë në fjalën gjentëlmen kryesues, sikur ju të pranojshit që me konsensus të keni 2 përfaqësues dhe unë e di se jeni grupi më i madh në Kuvendin komunal dhe jeni veç njëherë më shumë se PDK-ja. Ne e kemi një kandidat dhe po duket se jemi më gjentëlmen se ju sepse sikur ju të llogaritni 3 plus 3 bëjnë 6, që do e përfaqësoni Kuvendin komunal me këtë që po e them unë, me këtë konsensus të gjitha subjektet që kanë nga 2 kandidatë, atëherë s’do të kishim biseduar kaq gjatë. Këtu, do të ishit treguar shumë gjentëlmen.

**Ajet Berisha** – Ju i keni pasë emrat nga subjektet politike në KPF dhe z.Enver u tregua zemërgjerë që në vend të vetin e propozoi znj.Florije. Tash, hudhen në votim emrat që janë dhënë dhe kompletohet aspekti ligjor kryesues, për çka edhe është kthyer vendimi. Mbetet i zbrazët vendi i LDK-së, që sipas ligjit ata duhet me sjellë një emër të gjinisë femërore.

**Burim Gërguri** – Lexon emrat e propozuar për anëtarë të KPF-së dhe kërkon emrin e gjinisë femërore nga LDK-ja, në mënyrë që të plotësohet ky Komitet.

**Shaip Paloja** – Ne e kemi bërë një ankesë në MAPL, sepse nuk jemi të kënaqur lidhur me numrin e anëtarëve në KPF dhe derisa ta marrim përgjegjen emri ynë si përfaqësues në KPF do të jetë z.Fatos Kurshumliu. Vendimi i kaluar është sjellë në rishqyrtim, jo vetëm për arsye të gjinisë femërore, por edhe për shumë gjëra tjera. Ju lus që emrin e kandidatit tonë ta përfshini në KPF edhe nëse, e kthen Ministria është vendimi jonë.

**Burim Gërguri** – Propozimi i kaluar ka qenë që KPF-ja, të plotësohet me një anëtar të gjinise femërore dhe ashtu mbetet.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal votuan me 11 vota “Për” (duke përdorë votën e dyfishtë të Kryesuesit) me 10 vota “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” merret ky:

#### V E N D I M

**Plotësohet dhe ndryshohet Komiteti për Politikë dhe Financa me këta anëtarë :**

1. **Burim Gërguri**
2. **Floriye Jashari (AAK)**
3. **Qëndresa Dubova (AAK)**
4. **Gjinia femërore (LDK)**
5. **Hysni Mjeku (PDK)**
6. **Armend Rushiti (LB)**
7. **Slavisa Spasic (SLS)**

**Hysni Mjeku** – Kryesues duhet të keni parasysh se për një çështje nuk votohet 3,4 herë, por ju lutemi që punimet e Kuvendit të jenë sa më korrekte dhe ligjore sepse nuk guxojmë me anashkalie asnjë subjekt politik kësisoji. Në raste të tilla problemet duhet me i zgjidhë në mënyrë ligjore dhe shumë më ekspeditive dhe mos me lejue që Kuvendi të ndahet në 2 taborre sepse nëse, kjo ndodhë atëherë ne s’kemi bërë asgjë dhe unë nuk di pse vijë më në këtë Kuvend.

**Burim Gërguri** – Kjo ndodhi për shkak të transparencës që të shihen votat sepse e di se nuk votohet 2 herë për çështje të njejtë.

**Lulzim Sadiku** – Kërkoj nga opozita ta lëshojmë senacën për arsye se nuk po gjejmë konsensus dhe ju mund ta vazhdoni mbledhjen me 10 vota, pasi që e keni votën e dyfishtë.

Pas kësaj, anëtarët e LDK-së, të LVV-së dhe Lulzim Sadiku e lëshojnë mbledhjen.

Me kërkesën e z.Hysni Mjeku, këshilltarët komunal shkojnë në pauzë prej 15’ për konsultime.

**b) Burim Gërguri** – Tash pas pauzës që e patëm e kemi formimin e Komitetit për komunitete.

Tani, kryesuesi lexon raportin për nominimin e anëtarëve të komuniteteve joshumicë në Komitetin për komunitete, përpiluar nga bashkëpunëtorja profesionale për punë të Kuvendit komunal znj.Azize Zeneli.

**Shaip Paloja** – Kryesues, po i anashkalon gjërat sepse ne nuk e përfunduam KPF-në dhe po na detyron të marrim veprime që as vetë ne nuk i dëshirojmë. Ne jemi shumë të interesuar të jemi bashkëpunues në këtë Kuvend, për atë dhe jemi këtu, por ti po na neglizhon, po na anashkalon me mbivotim. Nëse propozimi ynë për KPF nuk kalon, atëherë nuk ka arsye që ne të qëndrojmë këtu.

**Burim Gërguri** – Konsideroj se çështja e KPF-së, është mbyllë dhe tash jemi duke diskutue për formimin e Komitetit për komunitete.

**Shaip Paloja** – Kryesues të keni parasysh se duhet të mernni përgjegjësi për veprimet që po i bën. Ne jemi të neglizhuar dhe të anashkaluar, kështu që në këtë seancë ne si opozitë nuk do të qëndrojmë.

**Hysni Mjeku** – Apeloj në emër të subjektit politik të PDK-së, që AAK-ja, ta rishikon edhe njëherë përbërjen e KPF-së, në mënyrë që ky Kuvend të jetë një Kuvend i fuqishëm dhe mos të tallen qytetarët me neve sepse ne jemi ardhë me votën e tyre. Unë po ju them sinqerisht se askund në Kuvendet komunale në Kosovë, një përfaqësim i tillë me 50 % nuk ekziston. Unë kam përvojë shumë të gjatë në institucione dhe çdoherë LDK-ja, ka qenë shumë fleksibile në rast të përfaqësimeve edhe pse ne kemi qenë numerikisht më pak, kemi qenë të përfaqësuar më shumë se që është dashur. Edhe kësaj radhe i nderuari kryesues, i nderuari Kryetar reflektoni që vërtetë ne të jemi pasqyrë e qytetarëve. Është moment për me reflektue sepse nuk po humbim, por po fitojmë të gjithë.



**Burim Gërguri** – Konsideroj se grupi i AAK-së, dha shembullin më të mirë për gjininë femërore dhe çështja e KPF-së, është përmbyllë. Besoj se kemi reflektue pozitivisht dhe askujt të padrejtë nuk i kemi bërë.

**Lulzim Sadiku** – Nëse, vërtetë nuk ka asnjë konsensus për këto që po i thotë opozita, dhe pasi që i keni numrat në s'mund të japim kontribut, atëherë kërkoj në emër të opozitës që ta lëshojmë seancën. Pas kësaj, anëtarët e LDK-së, të PDK-së dhe të LVV e lëshojnë seancën e Kuvendit komunal.

**Burim Gërguri** – Kalojmë në propozimet konkrete për Komitetin për komunitete.

**Dragan Dancetovic** – Mendoj se lista serbe në këtë pjesë të punës së Kuvendit është e anashkaluar dhe kur janë në pyetje zgjedhja e anëtarëve të Komitetit për Komunitete. Konfuzion ka krijuar ligji i cili tanë përnjëherë kërkon 50 me 50% të jenë të përfaqësuar si meshkujt e po ashtu edhe femrat, sepse në këtë proces kemi hyrë me 30 ndaj 70 % dhe ligji duhet të respektohet, por neve kjo në terren po na shkakton problem. Konsideroj se në Komitetin për Komunitete duhet të jetë përfaqësuesi i listës serbe.

**Slavisa Jakovljevic** – Kam një borxh ndaj jush, sepse nuk ju jam falenderuar në mbledhjen e kaluar me rastin e përzgjedhjes për Nënkryetar për komunitete. Tani po e shfrytëzoj rastin duke i falënderuar të gjithë ata që më përkrahën për këtë funksion dhe më duhet të them se ligji nuk është i përkryer sa i përket formimit të Komiteteve. Kemi pasur rastin që në mbledhjen e kaluar të zgjedhin anëtarët e Komitetit për Komunitete, nga radhët e Kuvendit Komunal. Mendoj se Kuvendi e ka kryer punën e vet, ashtu siç duhet, por fatkeqësisht pjesëtarët e partive tjera politike që janë në opozitë nuk kanë dalë me propozimin për anëtarë të KPF-së, e po ashtu edhe për Komitetin për Komunitete. Kësaj here po ndeshemi me një problem të madh e ky është barazia gjinore. Problemi me të cilin po ndeshemi është mirë i njohur, sepse nga radhët e komunitetit rom, kanë ardhur në takim dhe konsultime vetëm meshkujt dhe kjo po ashtu vlen edhe për komunitetin ashkali. Ajo që është më e dhimshme në mbledhjen e parë është paraqitur vetëm një pjesëtar i komunitetit serb, e në takimin e dytë nuk është paraqitur askush. Përfaqësuesit e grupit të këshilltarëve të LDK-së, kanë pasur të drejtë dhe mundësinë ta japin emrin e vet, ata dëshirojnë obstrukcione në punën e këtij Kuvendi. E para nuk është aspak e këndshme që e lëshuan mbledhjen e Kuvendit, ata mund të pajtohen ose jo me propozimet, por pjesëmarrja e çdo delegati në mbledhjen e Kuvendit është obligativ. Në komitetin për komunitete, kemi 3 përfaqësues nga radhët e komunitetit boshnjak, egjiptas dhe rom. Për ta formuar Komitetin për Komunitete, nevojiten edhe 2 anëtarë dhe propozoj që ata të jenë nga radhët e qytetarëve, të jenë nga radhët e komunitetit serb dhe në këtë rast jemi të detyruar të jenë nga gjinia femërore.

**Enver Gashi** – E përkrahu propozimin e NënKryetarit që 2 anëtarët e Komitetit për komunitete, të jenë nga qytetarët nëse, e lejon ligji dhe Rregullorja, në mënyrë që të bëjmë zgjidhje të çështjes.

**Kryetari** – Me këtë përbërje vendimi është mirë të dërgohet në MAPL dhe ata le ta vlerësojnë ligjshmërinë.

**Labinot Mirena** – Propozon që z.Agon Mjekiqi, të tërhiqet nga Komiteti për komunitete dhe në vend të tij të shkon znj.Nora Preniqi.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë :

#### V E N D I M

**Formohet Komiteti për komunitete me këta anëtarë :**

1. **Nora Preniqi (LB)**
2. **Lulzim Sadiku (PDK)**
3. **Nazmi Gashi (Nisma)**
4. **Faton Beka (Ashkali)**
5. **Avdyl Mustafa (Rom)**
6. **Haki Abazi (Egjiptian)**
7. **Enisa Boshnjak (Boshnjak)**
8. **Katarina Adjancic (serb)**
9. **Bobana Dancetovic (serb)**

e) **Burim Gërguri** – Edhe vendimi për formimin e KKSB-së, na ka ardhë për shqyrtim për arsye se nuk i kemi pasë emrat.

Tani kryesuesi lexon emrat e KKSB-së nga lista të cilën e ka sjellë Kryetari i Komunës.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë :

#### V E N D I M

**Formohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Obiliqit me këta anëtarë :**

1. **Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës**
2. **Sejdi Zeqiri, komandant i stacionit policor**
3. **Behar Mjekiqi, Përfaqësues i Bashkësisë Islame**
4. **Lejla Boshnjak, komuniteti boshnjak**
5. **Shaban Berisha, përfaqësues i komuniteteve**
6. **Kryesuesi i Komitetit për komunitete**
7. **Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore**
8. **Agim Spahiu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit**
9. **Arben Berisha, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit**
10. **Përfaqësuesi nga FSK-ja**
11. **Slavisa Jakovljevic, përfaqësues i komunitetit serb**
12. **Valon Berisha, nga sektori i emergjencës**
13. **Fatmir Bërbatovci, përfaqësues i Këshillit të prindërve**
14. **Zelushe Kelmendi, OJQ**
15. **Përfaqësuesi nga OJQ “Aureola”**
16. **Eljesa Tërbunja, OJQ “Handikos”**
17. **Slavisa Adjancic, ZKKK**
18. **Sejdi Haxholli, kordinator i EVSB-së**
19. **Naspalic Aleksandar, përfaqësues nga komuniteti ortodoks**
20. **Burim Gërguri, Kryetar i KLSP-sektori i I-rë**
21. **Jasmina Radanovic, përfaqësues e komunitetit malazez**

**V.Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Tani kemi shqyrtimin e kërkesës për inicimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale, që është një procedurë standarde e DFEZH-së. Neve, na duhet një aprovim formal prej juve që Rregullorja në fjalë të dalë në diskutim publik.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë :

#### V E N D I M

**Për dhënien në diskutim publik të Draft Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha komunale.**

**VI.Pika e gjashtë e rendit të ditës -**

**Burim Gërguri** – E kemi një kërkesë nga DSHMS për ndërtimin e QMF-së, në Milloshevë dhe për këtë fjalën ia japë drejtorit të DPUKP.

**Fatmir Bërbatovci** – Me kërkesën e DSHMS-së, ne e kemi propozue parcelën në Milloshevë, konkretisht te rrethi, numri i parcelës është 129 dhe ka mbi 2 ha hapësirë.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë :

#### V E N D I M

**Aprovohet kërkesa nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) për ndarjen e parcelës në sipërfaqe prej 10 ari nga parcela me nr.P-72614051-00129-1, ZK-Milloshevë, për ndërtimin e Qendrës Mjekësore Familjare (QMF).**

**VII.Pika e shtatë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Tash e kemi shqyrtimin dhe miratimin e Planit të veprimit për reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë për periudhën shkurt 2018 deri në dhjetor 2019. E ftoj përfaqësuesin e DKA-së, të na japë sqarim më detal.

**Rexhep Zeka** – Ju njoftoj se gjithsejt janë 30 nxënës, që e kanë mbaruar Arsimin e obligueshëm, por kanë mbetur edhe 18 nxënës që presin me përfundim klasën e 8 dhe 9. Ne e kemi llogaritë edhe buxhetin për këto 2 vite, në vlerën prej 6,858 €, që nënkupton një pagë të një mësimdhënësi brenda 1 viti. Këtu, gjithsejt bëjnë pjesë 6 mësimdhënës dhe është kordinatorja, e cila e menaxhon projektin.

**Enver Gashi** – Mendoj se Drejtoria e Arsimit duhet të marrë obligim që të bisedohet me Këshillat e fshatrave, nëse kemi ndonjë rast të ri përveç atyre që e kanë nisë dmth të vijin njerëzit dhe të aplikojnë, në mënyrë që ta përfundojnë shkollimin fillor.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë:

#### V E N D I M

Aprovohet vazhdimi i projektit për Planin e veprimit për reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë për periudhën shkurt 2018 deri në dhjetor 2019, në shumën prej 6,858.00 €.

VIII.Pika e tetë e rendit të ditës –

**Zarife Behluli** – Sqaron detalisht bartjen e mjeteve nga viti i kaluar në vitin vijues për të gjitha kategoritë ekonomike.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë:

#### V E N D I M

Lejohet bartja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 396,610.47 €.

Paga dhe mëditje	25,000.00
Mallra dhe shërbime	79,153.85
Shpenzime komunale	49,538.48
Subvencione dhe Transfere	21,950.62
Shpenzime Kapitale	220,967.52
Gjithsejt:	396,610.47

IX.Pika e nëntë e rendit të ditës –

**Kryetari** – Kërkon të formohet Komisioni për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe propozon 3 anëtarë nga Ekzekutivi: Fatmir Bërbatovcin, Naim Miftarin dhe Përparim Klinakun.

**Agon Mjekiqi** – Propozon z.Labinot Mirena, për anëtar të Komisionit.

**Nora Preniqi** – Propozon z.Armend Rushitin.

**Slavisa Spasic** – Propozon z.Dragan Dancetovic.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë:

#### V E N D I M

Formohet Komisioni vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me këtë përbërje:

1. Labinot Mirena, Kryetar
2. Armend Rushiti, anëtar
3. Dragan Dancetovic, anëtar
4. Fatmir Bërbatovci, anëtar
5. Naim Miftari, anëtar
6. Përparim Klinaku, anëtar

**Kryetari** – Duhet të formohet edhe Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe me këtë rast propozoj znj.Zarife Behluli, z.Edin Hashani dhe z.Ibush Mjekiqi.

Pas diskutimeve, këshilltarët komunal me shumicë votash morën këtë:

#### V E N D I M

Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me këtë përbërje:

1. Zarife Behluli, Kryetare
2. Edin Hashani, anëtar
3. Ibush Mjekiqi, anëtar

**X.Pika e dhjetë e rendit të ditës -**

**Burim Gërguri** – Ju njoftoj se kemi një kërkesë nga Hasan Krasniqi, për emërtimin e rrugës “Ali Gollaku” në Hamidi. Kërkesa të tilla janë 3, por më detalisht do të na shpjegoj drejtori i DPUKP-së.

**Fatmir Bërbatovci** – Ne si Drejtori i kemi trajtue 2 kërkesa, kërkesa e familjes Shalaku në Dardhishtë, e cila i plotëson standardet sipas Udhëzimit administrativ nr.12/2012, për caktimin dhe emërtimin e rrugëve. Kërkesa tjetër është në Mazgit të epërm, e familjes Raqi e cila poashtu i plotëson kriteret sipas Udhëzimit administrativ të cekur më lartë. Ndërsa, kërkesën e 3 të familjes Krasniqi, për emërtimin e rr.”Ali Gollaku” në Hamidi ende nuk e kemi trajtue.

**Ajet Berisha** – Sugjeron se lagj’ja ka të drejtë me u bë rrugë, nëse i plotëson kriteret. Kuvendi e ka miratuar listën e emrave të rrugëve dhe s’ka kushdo që don me caktue emrin e rrugës. Mirëpo, në bazë të renditjes i jepet emri rrugës dhe jo me i dhënë emër të ri rrugës.

**Fatmir Bërbatovci** – Ne jemi konsultuar edhe me AKP-në, në rastet kur ka kërkesa të banorëve dhe ka marrëveshje prej banorëve, ndërsa ai emër nuk figuron në listën rezervë të aprovuar nga Kuvendi komunal. Atëherë, ajo kërkesë duhet të shqyrtohet në Kuvend, përndryshe në rastet kur është emri i rrugës në listën rezervë, ne s’kemi nevojë me sjellë kërkesën në Kuvend.

**Ajet Berisha** – Sqaron se unë kam qenë në Komision për emërim të rrugëve dhe e di mirë gjendjen e tyre. Së pari, duhe të jetë kriteri për me qenë ajo rrugë, që e ka përcaktue AKP-ja, e dyta nuk mundet as lagjja, as fshati, as qyteti me imponue një emër i cili nuk është në kuadër të kriterëve për emërim. Thelbi është se lista e emrave reserve nuk diskutohet, por pas 5 viteve në rast se ka kërkesa më tepër prej se Kuvendi e ka nxjerrë vendimin dhe dojmë me pasë listë rezervë me vazhdue, ne mundemi në kuadër të kriterëve me vendosë edhe ndonjë emër, e jo lagjja me caktue emër. Lagjja mund të bëjë kërkesë, por emrin nuk mundet me ia caktue.

**Enver Gashi** – Këtu, janë 2 opsione nëse, nuk ka shkelje ligjore, por me pëlqimin e banorëve ashtu qysh po thotë drejtori i DPUKP, atëherë mund të shkojmë me ata emra për 2 rastet të familjes Raqi dhe Shalaku. Ne mund të marrim vendim dhe nëse, është në kundërshtim me ligjin Ministria e kthen.

**Labinot Mirena** – Pyet se a kanë qenë këto shtëpi në të kaluarën kur ka qenë Komisioni aktual sepse rruga që po përmendet te Shalakët, unë e di saktësisht se ku është.

**Fatmir Bërbatovci** – Sot i kemi 2 propozime, me u zgjerue lista rezervë me këta 2 emra, nuk është asnjë shkelje procedurale, ndërsa për të tretën nuk di, por ka mundësi të përcaktohet nga lista rezervë. Unë e kam Udhëzimin administrativ para vetes, jam konsultuar me AKP-në, dhe nuk dua si drejtor me ua imponue banorëve një emër që ata nuk e dojnë.

**Burim Gërguri** – Kërkesat e cekura më lartë shkojnë në DPUKP, në mënyrë që drejtori të na vjen me rekomandim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit komunal.

Pastaj, kryesuesi lexoi këto kërkesa:

-Kërkesën nga Kreshnik Balaj e cila iu përcollë DPUKP për shqyrtim dhe kërkoi interpretim ligjor për këtë lëndë, që në mbledhjen e ardhshme drejtori të vjen me rekomandim.

-Kërkesën nga Eljesa Tërbunja, për një zyre, e cila iu përcollë Drejtorisë së administratës për shqyrtim.

-Kërkesën nga OJQ “Aureola” nga Sanije Grajqevci, e cila poashtu kërkon një zyre dhe kjo kërkesë iu përcollë për shqyrtim Drejtorisë së administratës.

-Kërkesa nga KKZ-ja, nga Afrim Krasniqi i cili kërkon një zyre dhe kjo kërkesë iu përcollë për shqyrtim Drejtorisë së administratës.

-Kërkesën e dytë nga Eljesa Tërbunja për ndihmë financiare, personave me aftësi të kufizuar dhe kjo kërkesë iu përcollë DSHMS-së, për shqyrtim.

**Ibush Mjekiqi** – Kjo kërkesë e adresuar në Kuvend është nga praktikantët e mëhershme gabimisht e adresuar. DSHMS-ja, në bazë të Ligjit për shërbime sociale dhe familjare ka bërë thirrje publike dhe

çështja e kësaj OJQ-je, që ka konkuru zgjidhet në Drejtorinë tonë dhe Kuvendi s'ka nevojë të merret me këtë kërkesë. Ju i keni aprovuar subvencionet dhe tash është çështje e Drejtorive, kështu që ju mund të informoheni nga raporti që juve ju vjen pas një muaji ose 2 muajve, apo në raportin vjetor.

**Burim Gërguri** – Kërkesa e fundit është nga Besnik Kastrati për ndërrimin e tokës bujqësore në atë ndërtime dhe kjo kërkesë përcillet për shqyrtim në Drejtorinë e bujqësisë dhe në DPUKP.

#### **Të ndryshme -**

**Dragan Dancetovic** – Në mbledhjen e sotme do të doja ta paraqisja një çështje në emër të komunitetit serb dhe rom nga Plametini dhe ti paraqes qëndrimet e Listës serbe. Mendojmë se çdokush ka të drejtë në liri të lëvizjes dhe çdokush që të kthehet ku ka jetuar pa marrë parasysh cilit komunitet i takon. Megjithatë, ajo që po ndodh vitet e fundit në Plemetin, tek serbët dhe te romët, e besoj edhe te shqiptarët, paraqet brengë. Plemetini në njëfarë mënyre është shndërruar në “qendër të grumbullimit” për shumë njerëz, të cilët kurrë nuk kanë jetuar në Komunën e Obiliqit dhe kjo paraqet probleme të caktuara.

-Së pari probleme ekonomike, në Komunën tonë ka shumë të papunë, sidoms të njerëzve të rinj, e ata që po vijnë po ashtu, janë të papunë me ç'rast dobëson edhe më tej komunitetin tonë. Aty ku komuniteti është ekonomikisht i dobësuar, aty edhe krimi rritet.

-Rrezikohen marrëdhëniet ndërnjerëzore, ekziston mosdurim por edhe përlëshjet fizike, me çka destabilizohet Komuna jonë, veçanërisht komunitetin multi-etnik në Plemetin dhe krijohen rreziqe të sigurisë.


-Rrezikohet struktura demografike, e që nuk është problem nëse komuniteti është tolerant dhe nësa ata që vijnë janë të gatshëm të integrohen. Fatkeqësisht në këtë moment është fakt se ekziston një ndarje e shprehur dhe mosdurim ndërmjet komuniteteve.

Kjo gjendje Komunës së Obiliqit, i hap shumë çështje dhe problem prej atyre ekonomike deri tek të sigurisë e që nuk është lehtë pastaj për t'u zgjidhur, gjë që kërkon forca politike maksimale dhe ekonomike për zgjidhjen e problemeve dhe gjendjes së qëndrueshme, në vend të përparimit dhe zhvillimit. Qëndrimi i Listës serbe është që çdo person i zhvendosur në të ardhmen duhet të kthehet në Komunën e vet dhe aty të integrohet.

**Kryetari** - Ne i kemi pasë disa informacione që kanë ardhë dikund përmes UNICEF-it, rreth 25 familje të rikthyera në Kosovë dhe një pjesë më e madhe e tyre janë vendosë në Komunën tonë. Ne e kemi pasë një program me Ministrinë e kthimit edhe në mandatin e kaluar dhe sigurisht se ju keni njohuri se janë ndërtue disa shtëpi për të kthyerit. Shqetësim i joni i përbashkët i mëhershëm edhe i z.Slavisa Jakovljevic, z.Slavisa Adjancic dhe z.Slavisa Spasic, ka qenë pikërisht ky sa që e kemi sjellë në dyshim bashkarisht për me nënshkrue marrëveshjen me Ministrinë e kthimit dhe Bashkimin Evropian për ndërtimin e shtëpive për të kthyerit. Pas shumë konsultimeve, që i kemi pasë ne si Ekzekutiv kemi vendosë që me nënshkrue marrëveshjen për kthim, por ajo të vlen vetëm për qytetarët e Komunës tonë. Poashtu, e kemi mbajtur një takim me UNHCR-in, dhe i kemi njoftue se nuk do të lëshojmë leje për njerëz që nuk janë të Komunës tonë. Sipas të gjitha gjasave, kjo duket se ka qenë joshje pikërisht prej UNHCR-it. Tani, këshillë e jona është që ne në këtë rast të bashkëveprojmë Kuvendi dhe Ekzekutivi, që të mos lejojmë të vijnë njerëz nga Komunitat tjera, dhe të vendosen në Komunën tonë. Ne nuk do ta lëshojmë asnjë leje ndërtimi për ata njerëz të cilët nuk janë të Komunës tonë. Unë pajtohem me juve, që të gjithë të kthehen nëpër Komunitat e veta.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:5'**

Bashk.prof.për punë të KK

  
Azize Zeneli

Kryesuesi i Kuvendit komunal

  
Burim Gërguri

